

## 12.5 SHKURTORET

Është pjesë e dritares së shfletuesit, në të cilën paraqitet lista e shkurtoreve të regjistrimeve, të cilat në shfletues mund të përzgjidhen pa kërkim paraprak.



Shënim:

*Shkurtoret ruhen dhe shfaqen në mënyrë të veçantë për çdo përdorues.*

---

### 12.5.1 Shtimi i regjistrimit te shkurtoret

Regjistrimin mund ta shtoni te shkurtoret.

#### *Procedura*

1. Në hapësirën e punës përzgjidhni regjistrimin.
2. Përzgjidhni metodën **Objekti / Shto në shkurtore**.  
Hapet dritarja **Shkurtorja**.
3. Përzgjidhni emrin e shkurtoreve.
4. Klikoni butonin **Në rregull**.

Shkurtorja e re është në fund të listës së shkurtoreve.

#### *Mundësitë...*

Regjistrimin e veçantë nga hapësira e punës mund ta shtoni midis shkurtoreve duke e tërhequr atë me anë të miut deri tek hapësira e shfletuesit për shkurtoret.

Nëse në hapësirën e punës përzgjidhni disa regjistrime, ato mund t'i shtoni të gjitha njëherësh tek shkurtoret duke shtypur tastin <Ctrl> dhe me butonin e djathtë të miut i tërhiqni ato deri në pjesën e shfletuesit për shkurtoret.

---

### 12.5.2 Përdorimi i shkurtoreve

Regjistrimin mund ta zhvendosni nga pjesa e dritares me shkurtore në hapësirën e punës.

#### *Procedura*

1. Klikoni shkurtoren.
2. Përzgjidhni metodën **Shkurtoret / Shto objektin në hapësirën e punës**.

#### *Mundësitë...*

Regjistrimin e veçantë mund ta zhvendosni në hapësirën e punës edhe duke klikuar dy herë në shkurtore ose duke e tërhequr atë me anë të miut deri tek hapësira e punës.

Nëse në pjesën e shfletuesit me shkurtoret përzgjidhni disa regjistrime, ato mund t'i shtoni të gjitha njëherësh tek hapësira e punës duke shtypur tastin <Ctrl> dhe me butonin e djathtë të miut i tërhiqni ato deri në hapësirën e punës.

Procedura e riemërimit dhe fshirjes së shkurtores dhe kontrolli i vetive të regjistrimit të shkurtores është e përshkruar në manualin *Udhëzime themelore COBISS3*.